



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 16, datë 22.01.2020

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË ELEMENTËT DHE KUSHTET E
PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NË
NDËRTIM**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 02.10.2019 “Për sigurimin e ndërtimeve”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në elementët dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të detyrueshëm në ndërtim, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 207, datë 22.11.2019, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike dhe Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Në elementët dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të detyrueshëm në ndërtim, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 207, datë 22.11.2019, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 1, bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Pika 2, ndryshon me këtë përmbajtje:
“Zhvilluesi/Ndërtuesi/Investitori” është personi fizik apo juridik i cili përfshihet në aktivitetin e ndërtimit dhe që nënshkruan kontratën e sigurimit.
- Pika 7, ndryshon me këtë përmbajtje:
“Defektet në ndërtim” janë defekte që prekin pjesë të ndërtesës, pasurisë së paluajtshme, duke dëmtuar rezistencën dhe qëndrueshmërinë e saj si dhe defekte të tjera të rënda.”
- Pika 8, shfuqizohet.

2. Në nenin 4, pika 2 dhe 3, ndryshohen si më poshtë:

- “2. Kontrata e sigurimit hyn në fuqi në orën 24:00 të datës së nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me plotësimin e afatit 10-vjeçar që fillon të llogaritet nga data e nënshkrimit të kontratës.
- 3. Pagesa e primit do të kryhet e plotë nga zhvilluesi/ndërtuesi/investitori duke përfshirë edhe kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi.”

3. Në nenin 5, paragrafi i parë, ndryshon si më poshtë:

- “Shoqëria e sigurimit detyrohet të dëmshpërblejë të siguarin/përfituesin për dëmtime të ndodhura drejtpërdrejtë në ndërtesë, si:
-Shembjes tërësore ose pjesore të ndërtesës; apo
-Ndërtesa paraqet dukshëm rrezik për t’u shembur;
-Defekteve të tjera të rënda.”

4. Në nenin 6, pika d), ndryshon me këtë përmbajtje:

- “d. shkaktohen nga tërmeti, përmytja dhe ngjarje të tjera të ngjashme natyrore përveç kur objekti nuk është ndërtuar në përputhje me kushtet sizmike të zonës dhe legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë;”

5. Neni 9, ndryshon si më poshtë:

“Shoqëria e sigurimit lidh kontratën e sigurimit me kusht që të përmbushen kërkesat e mëposhtme:

- a. Subjekti të lëshojë një deklaratë që objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi;
- b. Aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit;
- c. Zhvilluesi/ndërtuesi/investitori të paraqesë të gjitha dokumentat ligjore që vërtetojnë përfundimin e punimeve në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit.”

6. Termi “Kontraktuesi” zëvendësohet me termin “Zhvilluesi/Ndërtuesi/Investitori”, në të gjithë përmbajtjen e kontratës.